

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration



MUNICIPAL PERFORMANCE GRANT
GRANTI I PERFORMANCËS KOMUNALE
OPŠTINSKI GRANT UČI NKA

Vlerësimi i performancës së vitit 2020 për **GRANTIN E PERFORMANCËS KOMUNALE** për vitin fiskal 2022

Mars, 2022





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Vlerësimi i performancës
së vitit 2020 për
GRANTIN E PERFORMANCËS
KOMUNALE
për vitin fiskal 2022

Mars, 2022

Përmbajtja

1. Vlerësimi i performancës së komunave për grantin e vitit 2022 - Hyrje	3
1.1 Hyrje	3
1.2 Mbulueshmëria gjeografike	4
1.3 Struktura e raportit dhe audienca e synuar	4
2. Granti i performancës komunale për vitin 2022 – Metodologjia e vlerësimit	6
2.1 Aspekte të përgjithshme të metodologjisë së vlerësimit	6
2.1.1 Periudha e vlerësimit për Grantin e Performancës Komunale (Ciklet e Menaxhimit të Grantit)	6
2.1.2 Kushtet minimale	6
2.1.3 Treguesit e Grantit për Performancë Komunale	6
2.1.4 Burimet e të dhënave për vlerësimin e kushteve minimale dhe të treguesve të grantit të performancës komunale	8
2.1.5 Burimet e financimit të grantit të performancës komunale	8
2.1.6 Llogaritja e shumës së grantit të performancës komunale	8
2.2 Procesi i vlerësimit	9
2.2.1 Aranzhimet institucionale	9
2.2.2 Procedurat paraprake të vlerësimit	10
3. Granti i performancës komunale për vitin 2022 – Rezultatet finale të vlerësimit	11
3.1 Rezultatet e kushteve minimale	11
3.2 Rezultatet e treguesve të Grantit për Performancë Komunale	12
3.2.1 Rezultatet e përgjithshme për treguesit e Grantit të Performancës Komunale	12
3.2.2 Rezultatet për treguesit e GPK-së në temën 'Qeverisja Demokratike'	13
3.2.3 Rezultatet për treguesit e GPK-së në temën 'Menaxhimi Komunal'	13
3.2.4 Rezultatet për treguesit e GPK-së në temën 'Ofrimi i shërbimeve'	13
3.2.5 Përmbledhje e rezultateve për treguesit grantit për performancë	14
3.3 Granti i performancës komunale për vitin 2022 – shumat e grantit	16
3.4 Përmbledhje e rezultateve finale të vlerësimit dhe rekomandime	18
Shtojcat	18
Shtojca 1 – Rezultati i përgjithshëm i kushteve minimale – performanca e vitit 2020	19
Shtojca 3 – Përmbledhje e rezultatit të performancës individuale të komunave	23

1. Vlerësimi i performancës së komunave për grantin e vitit 2022 - Hyrje

1.1 Hyrje

Në fund të vitit 2017, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), në partneritet me Zyrën Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), zhvilluan dhe u pajtuan të bashkëfinancojnë skemën për ndarjen e grantit të performancës komunale (GPK) për komunat. Në vitin 2019, Suedia dhe Norvegjia kanë vendosur që të bashkëfinancojnë skemën e GPK. Në vitin 2022, BE përmes Suedisë do të bashkohet financimit të skemës së GPK.

Në mars 2022 është realizuar vlerësimi i komunave për grantin e performancës për vitin fiskal 2022 sipas performancës së vitit 2020 **për kushtet minimale dhe treguesit e përcaktuar në Rregullat e Grantit të Performancës për vitin fiskal 2022.**

Granti i Performancës Komunale (GPK) i vitit 2022 do t'i ndahet komunave të cilat kanë përmbushur kushtet minimale të paraqitura më poshtë:

1. Komunat duhet të kenë raportuar të dhënat në SMPK sipas afatit të përcaktuar në nenin 13 të Rregullores së SMPK/GPK ;
2. Komunat duhet të kenë respektuar obligimin ligjor për të rishqyrtuar aktet komunale të vlerësuara si të kundërligjshme nga autoriteti mbikëqyrës ;
3. Opinioni i auditimit duhet të jetë të paktën i pamodifikuar me theksim të çështjes; dhe
4. Komunat duhet të kenë shpenzuar 75% ose më tepër të buxhetit final për investime kapitale pas përfshirjes së pagesave të përealizuara¹.

Granti i Performancës Komunale (GPK) për vitin fiskal 2022 do t'i ndahet komunave në pajtim me pikët e arritura në performancën komunale në bazë treguesve në tri tema kryesore: (i) qeverisja demokratike, (ii) menaxhimi komunal, dhe (iii) ofrimi i shërbimeve.

Këto tri tema ndahen tutje në dhjetë nëntema siç janë të paraqitura më poshtë në Tabelën 1. Në kuadër të këtyre dhjetë nën-temave, janë identifikuar 30 tregues të performancës (shih Tabelën 2).

Është e rëndësishme të përmendet se 28 tregues do të vlerësohen për përcaktimin e grantit që jepet në Vitin Fiskal 2022, për të cilët vlerësimi bëhet bazuar në performancën e vitit 2020.

Treguesi nr. 6 do të vlerësohet pjesërisht. Totali i pikëve për këtë tregues në këtë cikël të vlerësimit është 2 pikë, kjo ngase pjesëmarrja e grave në takime publike nuk do të hyn në kalkulim. Situata e pandemisë ka ndikuar në kufizimin e takimeve publike dhe identifikimi i pjesëmarrësve sipas gjinisë është shumë i vështirë përmes platformave online.

Treguesi nr.19 (me ngjyrë portokalli në Tabelën 2) është i ngrirë që do të thotë se rezultati për këtë tregues nuk do të merret parasysh në totalin e pikëve, për shkak të ndryshimit të ligjit për zyrtarët publik dhe mungesës së legjislacionit sekondar lidhur me procedurat e rekrutimit në shërbimin civil.

Treguesi nr. 27 (me ngjyrë portokalli në Tabelën 2) është 'ngrirë' që do të thotë se rezultati për këtë tregues nuk do të merret parasysh në totalin e pikëve, për arsye se të dhënat e raportuara nga komunat kanë qenë të mangëta dhe janë konsideruar të pavlefshme në raportin e SMPK-së për vitin 2020.

Numri maksimal i pikëve për 28 treguesit që do të vlerësohen është 92 pikë. Këto pikë, siç do të shpjegohet në kapitullin 2, përcaktojnë shumën e grantit të performancës komunale që merr komuna për performancën e vitit 2020.

¹ Shkresa nga MFTP me numër protokollit 11-400-734/1 të dates 19 Gusht 2021

Tabela 1: Tre temat kryesore dhe dhjetë nën-temat me pikët maksimale për grantin që do të ndahet në 2022

Temat dhe nën-temat	Pikët që mund të merren për grantin e vitit fiskal 2022
1. Qeverisja demokratike	38
I Roli i kuvendit komunal si organ mbikëqyrës	13
II Pjesëmarrja, konsultimi dhe gjithpërfshirja e qytetarëve	10
III Transparenca, qasja në informata dhe integriteti	15
2. Menaxhimi komunal	28
IV Menaxhimi financiar	13
V Menaxhimi i kontratës	7
VI Menaxhimi i burimeve njerëzore	8
3. Ofrimi i shërbimeve	26
VII Shërbimet administrative	6
VIII Planifikimi hapësinor, transporti publik dhe mjedisi	8
IX Arsimiti para-universitar	4
X Kujdesi parësor shëndetësor (KPSH)	8
Numri maksimal i pikëve që mund të merren për grantin e vitit 2022	92

1.2 Mbulueshmëria gjeografike

Vlerësimi i performancës për grantin e vitit 2022 është bërë për të gjitha komunat e Republikës së Kosovës.

1.3 Struktura e raportit dhe audiencia e synuar

Në këtë dokument, bëhet prezantimi i procesit të vlerësimit të performancës së komunave gjatë vitit 2020 dhe rezultateve finale të vlerësimit për grantin e performancës komunale që do të ndahet në vitin 2022, si dhe jepen informata lidhur me shumën e grantit për komunat e kualifikuara.

Kapitulli 1 – ofron informata të përgjithshme për grantin e performancës komunale, fushat ku përqendrohet ai, si dhe pikët maksimale që mund të marrin komunat në treguesit e performancës sipas rezultateve të vitit 2020.

Kapitulli 2 – shtjellon metodologjinë e vlerësimit, kushtet minimale, treguesit e performancës si dhe procesin e vlerësimit.

Kapitulli 3 – shpalos rezultatet finale të vlerësimit për kushtet minimale, treguesit e performancës si dhe rezultatin sipas temave dhe nëntemave. Ky kapitull poashtu prezanton shumat e grantit të performancës komunale të cilat do t'i transferohen komunave në vitin 2022.

Në të njëjtën kohë, shtojcat japin informata më të hollësishme të rezultateve të vlerësimit për kushtet minimale (shtojca 1) dhe për treguesit e performancës (shtojca 2). Shtojca 3 jep një përmbledhje të rezultateve të vlerësimit për secilën komunë.

Ky dokument është i hartuar në radhë të parë për anëtarët e Komisionit të Grantit të

Performancës Komunale (KGPK) dhe do të jetë në dispozicion për të gjithë akterët në të gjitha komunat e Kosovës, e sidomos kryetarët e komunave, drejtorët, udhëheqësit e lartë, koordinatorët e SMPK-së, asambleistët e kuvendeve komunale dhe qytetarët e interesuar. Në nivelin qendror, ky dokument, përvec KGPK-së do të jetë me interes për të gjitha ministritë që hartojnë politika me ndikim për komunat, si dhe organizatat jo-qeveritare (OJQ) që trajtojnë ofrimin e shërbimeve lokale dhe qeverisjen lokale. Ky dokument po ashtu mund t'u shërbejë partnerëve ndërkombëtarë të cilët mendojnë t'i bashkëngjiten ose t'i përafrojnë skemat e tyre të granteve me grantin e performancës komunale.

2. Granti i performancës komunale për vitin 2022 – Metodologjia e vlerësimit

2.1 Aspekte të përgjithshme të metodologjisë së vlerësimit

'Rregullat e Grantit të Performancës Komunale për vitin fiskal 2022', të miratuara nga MAPL, BE, Suedia, Zvicra dhe Norvegjia, paraqesin dokumentin kryesor në bazë të të cilit është bërë vlerësimi për grantin e performancës komunale për vitin 2022. Rregullat e GPK 2022 i shpjegojnë politikat prapa këtij granti si dhe japin udhëzime të detajuara lidhur me procesin e vlerësimit të performancës.

2.1.1 Periudha e vlerësimit për Grantin e Performancës Komunale (Ciklet e Menaxhimit të Grantit)

Periudha e vlerësimit për grantin e performancës komunale ndahet në 3 faza kryesore:

- **Periudha e performancës** - që nënkupton vitin për të cilin vlerësohet performanca e komunës. Në bazë rregullave të GPK 2022 vlerësohet performanca komunale e vitit 2020;
- **Periudha e vlerësimit** - nënkupton periudhën në të cilën kryhet vlerësimi i performancës për GPK.
- **Periudha e ndarjes dhe shfrytëzimi i grantit** - nënkupton vitin në të cilin granti vihet në dispozicion për shfrytëzim nga komunat. Në bazë të këtyre rregullave granti do të jetë në dispozicion për komunat në vitin 2022.

2.1.2 Kushtet minimale

Për tu kualifikuar për grantin e performancës komunale për vitin 2022, komunat duhet t'i kenë plotësuar 4 kushtet minimale për sa vijon:

1. Komunat duhet të kenë raportuar të dhënat në SMPK sipas afatit të përcaktuar në nenin 13 të Rregullores së SMPK/GPK²;
2. Komunat duhet të kenë respektuar obligimin ligjor për të rishqyrtuar aktet komunale të vlerësuara si të kundërligjshme nga autoriteti mbikëqyrës³;
3. Opinioni i auditimit duhet të jetë të paktën i pamodifikuar me theksim të çështjes; dhe
4. Komunat duhet të kenë shpenzuar 75% ose më tepër të buxhetit final për investime kapitale pas përfshirjes së pagesave të parealizuara⁴.

Komunat që nuk kanë plotësuar një nga kushtet minimale të lartpërmendura, nuk do të mund të marrin grant të performancës komunale, pavarësisht pikëve të tyre në treguesit e performancës.

Për të gjitha komunat që kanë plotësuar kushtet minimale, granti i performancës komunale që merr secila komunë bazohet në pikët e saj relative të arritura në 28 treguesit e performancës (pikët e saj në krahasim me ato të të gjitha komunave të tjera).

2.1.3 Treguesit e Grantit për Performancë Komunale

Siç shihet në tabelën 2 më poshtë, për grantin që do të alokohet në 2022 janë vlerësuar gjithsej 28 tregues të performancës komunale sipas rezultateve të arritura nga komunat në vitin 2020⁵ nën tre fusha kryesore dhe dhjetë nën-fusha (shih gjithashtu tabelën 1 më lart).

² Afati i raportimit të të dhënave të performancës nga komuna është 45 ditë kalendarike nga momenti i pranimit të kërkesës për raportim nga ministria

³ Rishqyrtimi për qëllime të GPK-së është kriter procedural, që nënkupton obligimin e komunës për të rishqyrtuar në Kuvendin e Komunës aktet e vlerësuara si të kundërligjshme në vitin 2020 nga autoriteti mbikëqyrës, pa presupozuar përmbajtjen përfundimtare të aktit të rishqyrtuar.

⁴ Shkresa nga MFTP me numër protokollit 11-400-734/1 të dates 19 Gusht 2021

⁵ Treguesit me numër 19 dhe 27, janë tregues 'itë ngrirë' dhe nuk janë vlerësuar për grantin e performancës komunale të vitit 2022. Përderisa treguesi me numër 6 do të vlerësohet pjesërisht.

Tabela 2: Përmbledhje e fushave, nënfushave dhe treguesve të vitit 2020 për grantin e performancës komunale për vitin fiskal 2022⁶

#	Fushat, nënfushat dhe treguesit	# maks. i pikëve
I. QEVERISJA KOMUNALE - Roli i Kuvendit Komunal, Pjesëmarrja dhe Përfshirja e qytetarëve, Transparenca dhe Llogaridhënia		38
I	Roli i kuvendit komunal si organ mbikëqyrës	13
1	Miratimi me kohë i propozim buxhetit vjetor komunal	2
2	Diskutimi për raportet tremujore buxhetore nga Kuvendi Komunal	3
3	Diskutimi për raportin e performancës komunale nga Kuvendi Komunal për vitin praparak	2
4	Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve si dhe diskutimi i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi i brendshëm në Kuvendin Komunal	4
5	Mbledhje të Kuvendit Komunal me pjesëmarrje të kryetarit të komunës	2
II	Pjesëmarrja, konsultimi dhe gjithëpërfshirja e qytetarëve	10
6	Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike, i disagreguar sipas gjinisë	2
7	Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun	4
8	Dëgjimet publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) dhe buxhet komunal	4
III	Transparenca, qasja në informata dhe integriteti	15
9	Mbledhjet e kuvendit të bëra publike dhe transmetuara drejtpërdrejtë online	3
10	Përmbushja e kriterëve të faqes zyrtare elektronike të komunës	4
11	Publikimi i dokumenteve të prokurimit publik të komunës	2
12	Publikimi i raporteve për procese të konsultimeve publike	4
13	Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit para Kuvendit Komunal	2
II. MENAXHIMI KOMUNAL - Menaxhimi financiar, Menaxhimi i kontratës dhe Menaxhimi i BNj		28
IV	Menaxhimi financiar	13
14	Niveli i azhurnimit të regjistrit të tatimit në pronë	3
15	Niveli i mbledhjes së faturës së tatimit në pronë (pa borxhe, interesa, ndëshkime)	5
16	Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit	5
V	Menaxhimi i kontratave	7
17	Niveli i zbatimit i planit të prokurimit	3
18	Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim	4
VI	Menaxhimi i burimeve njerëzore	8
19	Vende të hapura pune të proceduara përmes SIMBNj	2
20	Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet e arsimit, shëndetësisë dhe kulturës	5
21	Gratë e emëruara në poste politike në komunë	3
III. OFRIMI I SHËRBIMEVE - Qasja dhe cilësia e ofrimit të shërbimeve - Sipas sektorit		26
VII	Shërbimet administrative	6
22	Rastet e kërkesave administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore	4
23	Kërkesat të shqyrtuara për leje të ndërtimit	2
VIII	Planifikimi hapësinor, transporti publik dhe mjedisi	8
24	Sipërfaqja e territorit të komunës e mbuluar me plane rregulluese (të hollësishme)	3
25	Vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik	3
26	Realizimi i Planit Lokal të Veprimit në mjedis	2
IX	Arsimi para-universitar	4
27	Fëmijët që vijnë në kopshtin – rural dhe përgjithësi	4
28	Kalueshmëria në testin e maturës kombëtare kl.12	4
X	Kujdesi shëndetësor primar	8
29	m ² të hapësirave Kujdesit Primar Shëndetësor për 10000 banorë	3
30	Niveli i pajtueshmërisë me raportin 1 specialist i mjekësisë familjare edhe 2 infermierë për 2000 banorë	5

⁶ Shpjegimi më i hollësishëm i temave të treguesve dhe ngjyrave mund të gjendet në tekst dhe në shtojcën 2 të Rregullave të grantit të performancës komunale për VF 2022.

Tregues të ndryshëm kanë numër të ndryshëm të pikëve, varësisht nga pesha dhe rëndësia e atribuar e një treguesi. Shtojca 2 e Rregullave të grantit të performancës komunale për VF 2022 përmban një udhëzues të detajuar lidhur me alokimin e pikëve përbrenda pikëve maksimale. Pikët janë kalibruar në mënyrë të tillë që të shpërblehen nivele të mira dhe të pranueshme të performancës, por që për secilin tregues, për performancën nën-optimale jepen shumë pak ose aspak pikë, që do të thotë se pikët me të vërtetë stimulojnë performancën e mirë (në vend të performancës mesatare). Kjo gjithashtu do të thotë se komunat që performojnë mirë në një numër treguesish, do të marrin ndjeshëm më shumë pikë se ato që tregojnë performancë të rëndomtë.

2.1.4 Burimet e të dhënave për vlerësimin e kushteve minimale dhe të treguesve të grantit të performancës komunale

Të dhënat për vlerësimin e performancës për grantin e vitit 2022 vijnë nga burimet e mëposhtme: i) Raporti i Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale për vitin 2020 (SMPK) i MAPL-së, i publikuar nga MAPL; ii) Raporti i funksionimit të komunave të Kosovës për vitin 2020 i MAPL-së, i publikuar më 07.04.2021 nga MAPL; iii) Raportet e auditimit të rregullsisë për secilën prej 38 komunave, të publikuara nga ZKA; 4) Të dhënat për shumatat totale të pagesave që nuk janë realizuar për shkak të arritjes së limitit të bilancit bankar – shkresa e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve me numër protokoli: 11-400-734/1 të datës 19 Gusht 2021.

2.1.5 Burimet e financimit të grantit të performancës komunale

Granti i performancës komunale për vitin 2022 bashkë-financohet nga MAPL, BE, Suedia, Zvicra dhe Norvegjia.

Shuma e përgjithshme e disponueshme për grantin e performancës komunale së vitit 2022 është 8 milionë euro.

Për të monitoruar ndikimin e projekteve tek qytetarët, është vendosur auditimi shoqëror në kuadër të GPK. Shuma për auditimin shoqëror për vitin 2022 është zbritur nga totali i shumës së GPK. Andaj në tabelën 3 është paraqitur shuma indikative e GPK që do t'i alokohet komunave.

Tabela 3: Burimet e financimit të grantit të performancës komunale për vitin 2022 (në euro)

Fondet	Burimi	Total 2022
Shuma indikative e GPK në dispozicion për komuna	Qeveria e Kosovës /MAPL	3,000,000
	Kontributdhënësit (BE, Suedia, Zvicra dhe Norvegjia)	4,921,500
Buxheti për auditim shoqëror	Kontributdhënësit (BE, Suedia, Zvicra dhe Norvegjia)	78,500
Gjithsej		8,000,000

2.1.6 Llogaritja e shumës së grantit të performancës komunale

Shuma e alokimit të grantit të performancës komunale përcaktohet nga (i) performanca relative e secilës komunë për vitin 2020 e matur sipas treguesve të përcaktuar të performancës dhe (ii) pesha e grantit të performancës komunale në grantin e përgjithshëm të alokuar për vitin 2022. Detajet për mënyrën se si është llogaritur ndarja e grantit të performancës komunale për vitin 2022 janë dhënë në nën-kapitullin 3.3 – Granti i performancës komunale për vitin 2022.

Shuma e grantit të përgjithshëm për komunat për vitin 2022 është marrë nga Ligji nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022.

2.2 Procesi i vlerësimit

2.2.1 Aranzhimet institucionale

Komisioni i grantit të performancës komunale (KGPK) dhe grupi teknik janë organet përgjegjëse për vlerësimin dhe ndarjen e grantit të performancës komunale. Komisioni i ankesave shqyrton dhe vendosë lidhur me ankesat e komunave. Komisioni i ankesave nuk do të rishikojë ankesat që ndërlidhen me burimin e të dhënave të përdorura gjatë vlerësimit.

KGPK është organi më i lartë vendimmarrës për grantin. Ky komision merr përgjegjësinë përfundimtare për ndarjen e grantit. Funkzioni kryesor i KGPK-së është të garantoj se vlerësimi është bërë në pajtim me kriteret dhe rregullat e grantit të performancës komunale. KGPK nuk mund të ndryshojë rezultatet e vlerësimit dhe shumat e grantit pa aplikimin e tërësishëm të procesit të vlerësimit në pajtim me rregullat e grantit.

Komisioni i grantit të performancës komunale përbëhet nga:

- 1 anëtar nga MAPL (Sekretar i përgjithshëm/Kryesues),
- 1 anëtar - zyrtar publik i nivelit drejtues të ministrisë,
- 1 anëtar - zyrtar publik nga ministria përgjegjëse për financa,
- 1 vëzhgues nga Unioni Evropian në Kosovë,
- 1 vëzhgues nga Suedia,
- 1 vëzhgues nga Zvicra,
- 1 vëzhgues nga Norvegjia, dhe
- vëzhgues nga shoqëria civile.

Grupi teknik përbëhet nga 5 anëtarë:

- 3 anëtarë nga njësia përgjegjëse për performancë komunale; dhe
- 2 anëtarë nga projekti DEMOS (të cilët përfaqësojnë subjektet kontributdhënëse);
- 1 përfaqësues i shoqërisë civile (vëzhgues).

Komisioni i ankesave përbëhet nga 3 anëtarë:

- 2 përfaqësues nga MAPL (njëri prej tyre kryesues);
- 1 përfaqësues i jashtëm;
- 2 vëzhgues DEMOS

Anëtarët e komisionit të grantit apo grupit teknik nuk mund të jenë anëtarë të komisionit të ankesave.

Termat e detajuara të referencës për Grupin Teknik, Komisionin e Grantit të performancës komunale dhe Komisionit të ankesave, jepen në shtojcat 5, 6 dhe 7 të Rregullave të grantit të performancës komunale për vitin fiskal 2022.

2.2.2 Procedurat paraprake te vlerësimit

Përgatitjet

Grupi teknik i ka përgatitur Rregullat e GPK-se për VF 2022. Rregullat për VF 2022 janë miratuar nga MAPL dhe kontributdhënësit dhe pastaj ato i'u janë shpërndarë komunave dhe janë publikuar në web faqen e MAPL-së.⁷

Mbledhja dhe vlerësimi i të dhënave

Grupi teknik i ka mbledhur të dhënat për vlerësimin e performancës së vitit 2020. Të dhënat janë transferuar në një bazë të të dhënave për secilin kusht minimal dhe për secilin tregues të performancës. Të gjitha të dhënat janë përshkruar nga burimi i të dhënave. Grupi teknik nuk ka ndryshuar asnjë të dhënë burimore. Këto të dhëna kanë përcaktuar rezultatin e vlerësimit të kushteve minimale si dhe nivelin e pikëve të fituara për treguesit e performancës, në përputhje me udhëzimet për vlerësim të përshkruara në shtojcën 2 të Rregullave të grantit të performancës komunale për VF 2022. Së pari është vlerësuar nëse janë përmbushur ose jo kushtet minimale për secilën komunë. Ky vlerësim i ka përcaktuar komunat që kualifikohen si dhe ato që nuk kualifikohen (shih shtojcën 1). Hapi i radhës ka qenë vlerësimi i treguesve të performancës. Pikët totale të fituara janë regjistruar në tabelën e ndarjes së grantit të performancës komunale, e cila e përlllogaritë shumën e grantit të performancës komunale për secilën komunë që është kualifikuar (Tabela 7). Më pastaj janë përcaktuar komunat me performancën më të mirë dhe janë ndarë shpërblimet shtesë sipas rregullave. **Në këtë vit, performancë më të lartë ka treguar Komuna e Rahovecit me 64 pikë, duke fituar shpërblimin shtesë prej 5% të vlerës së përgjithshme të GPK, komuna e dytë është Komuna e Lipjanit me 63.5 pikë, duke fituar shpërblimin shtesë prej 3% të vlerës së përgjithshme të GPK, kurse komuna e tretë është komuna e Gillogocit me 62 pikë duke fituar shpërblimin shtesë prej 2% të vlerës së përgjithshme të GPK.** Pas kësaj, fletënotimi (shih shabllonin në shtojcën 3 të Rregullave të grantit të performancës komunale për VF 2022 si dhe shtojcën 4 të këtij dokumenti) është plotësuar me rezultatet për çdo komunë⁸. Vlerësimi i treguesve të performancës është bërë për të gjitha komunat, përfshirë edhe ato që nuk i kanë plotësuar kushtet minimale.

Gjatë gjithë procesit të vlerësimit, është realizuar edhe kontrolli i cilësisë së të dhënave të transferuara në fletënotime dhe në bazën e të dhënave. Në fund, është bërë edhe një kontroll përfundimtar i formulave të përdorura dhe rezultateve (pikëve).


⁷ <https://mapl.rks-gov.net/performance-komunale/rregullat-e-grantit-te-performances-komunale/>

⁸ Nëse një komunë nuk ka dorëzuar të dhëna për ndonjë tregues, performanca për këta tregues do të jetë zero.

3. Granti i performancës komunale për vitin 2022 – Rezultatet finale të vlerësimit

3.1 Rezultatet e kushteve minimale

14 nga 38 komunat e vlerësuara i kanë përmbushur të katër kushtet minimale dhe **janë kualifikuar për grant të performancës komunale për vitin 2022**. Kjo do të thotë që 36.84% e komunave në Kosovë do të jenë komuna përfituese⁹ të grantit të performancës komunale në vitin 2022.



- 37 nga 38 komunat (>97.37%) e kanë përmbushur kushtin e parë minimal (Komunat duhet të kenë raportuar të dhënat në SMPK sipas afatit të përcaktuar).
- 29 nga 38 komunat (>76.32%) e kanë përmbushur kushtin e dytë minimal (Komunat duhet të kenë respektuar obligimin ligjor për t'i rishqyrtuar aktet komunale të vlerësuara si të kundërligjshme nga autoriteti mbikëqyrës).
- 24 nga 38 komunat (>63.15) e kanë përmbushur kushtin e tretë minimal (Opinionin e auditimit duhet të jetë i paktën i pamodifikuar me theksim të çështjes).
- 25 nga 38 komunat (>65.79%) e kanë përmbushur kushtin e katërt minimal (Komunat duhet të kenë shpenzuar 75% ose më tepër të buxhetit final për investime kapitale pas përfshirjes së pagesave të përealizuara)¹⁰.

Përmbledhja e rezultateve të kushteve minimale për të gjitha komunat, është dhënë në shtojcën numër 1, ndërsa shtojca numër 2 jep një përmbledhje të rezultateve për secilën komunë veç e veç.

⁹ Dragash, Gjilan, Glogovc, Graçanicë, Hani i Elezit, Kaçanik, Lipjan, Mitrovicë e jugut, Obiliq, Pejë, Rahovec, Shtërpocë, Suharekë dhe Viti.

¹⁰ Shkresa nga MFTP me numër protokollit 11-400-734/1 të datës 19 Gusht 2021

3.2 Rezultatet e treguesve të Grantit për Performancë Komunale


3.2.1 Rezultatet e përgjithshme për treguesit e Grantit të Performancës Komunale

Performanca mesatare e të gjitha 38 komunave në 28 treguesit e performancës për vitin 2020 (grantin e vitit 2022) është **~38.90%** (~35.79 pikë nga gjithsej 92 pikë të mundshme), ndërsa performanca mesatare e komunave që janë kualifikuar për grantin e performancës komunale është ~46.81% (~43.07 pikë nga gjithsej 92 pikë të mundshme).

Të dhënat e raportuara nga Komuna e Mitrovicës Veriore janë vendosur në Sistemin Elektronik pa nënshkrim/autorizim të kryetarit. Lidhur me këtë, është kërkuar konfirmim me shkrim nga kryetari i Komunës, i cili nuk është përgjigjur, për çfarë të dhënat për këtë komunë janë shpallur të pavlefshme sipas Reportit të Performancës Komunale 2020.

Rezultati mesatar i treguesve të performancës së vitit 2020 për secilën komunë veç e veç është dhënë në figurën numër 1 më poshtë. 9 nga 38 komunat (23.68%) kanë arritur një performancë mesatare mbi 50% në 28 treguesit e performancës.

Figura 1: Performanca e përgjithshme në 28 tregues të GPK-së sipas komunave në përqindje



Komuna me performancën më të lartë në 28 treguesit e performancës së vitit 2020 është Komuna e Rahovecit. Rezultati i përgjithshëm i performancës së Komunës së Rahovecit është 64 nga 92 pikë të mundshme (69.57%).

11 nga 38 komuna kanë arritur një performancë të përgjithshme ndërmjet 37 dhe 46 pikëve (40-50%).

Komuna e Mitrovicës Veriore dhe Zubin Potoku ka rezultatin më të ulët mesatar në 28 treguesit e performancës. Rezultati i përgjithshëm i performancës së Komunës së Mitrovicës së Veriut dhe Zubin Potokut është 1 pikë nga 92 pikë të mundshme (1.09%).

3.2.2 Rezultatet për treguesit e GPK-së në temën 'Qeverisja Demokratike'

Performanca mesatare e 38 komunave në 13 treguesit e vlerësuar në kuadër të temës 'Qeverisja demokratike' është ~15.18¹¹ pikë nga gjithsej 38 pikë të mundshme në këtë temë (39.96%). 3 komunat me performancën më të lartë në këtë temë janë: Komuna e Lipjanit, Komuna e Skenderaj dhe Komuna e Rahovecit. Këto komuna kanë treguar performancë nga 28 – 30.5 pikë (73.68% - 80.26%).

Në nën-temën **'Roli i Kuvendit Komunal si organ mbikëqyrës'** performanca e përgjithshme mesatare për 5 tregues të vlerësuar është 6.58 pikë nga 13 pikë të mundshme (50.61%).

Në nën-temën **'Pjesëmarrja, konsultimi dhe gjithëpërfshirja e qytetarëve'**, performanca e përgjithshme mesatare për 3 tregues të vlerësuar është 3.79 pikë nga 10 pikë të mundshme (37.89%).

Në nën-temën **'Transparenca, çasja në informata dhe integriteti'**, performanca e përgjithshme mesatare për 5 tregues të vlerësuar është 4.82 pikë nga 15 pikë të mundshme (32.11%).

3.2.3 Rezultatet për treguesit e GPK-së në temën 'Menaxhimi Komunal'

Performanca mesatare e 38 komunave në 7 treguesit e vlerësuar në kuadër të temës 'Menaxhimi Komunal' është 9 pikë nga gjithsej 28¹² pikë të mundshme në këtë temë (31.48%). Komuna me performancën më të lartë në këtë temë është Komuna e Junikut. Kjo komunë ka fituar gjithsej 22 pikë nga 28 pikë të mundshme (78.57%).

Në nën-temën **'Menaxhimi financiar'** performanca e përgjithshme mesatare për 3 tregues të vlerësuar është 3.11 nga 13 pikë të mundshme (23.89%).

Në nën-temën **'Menaxhimi i kontratës'**, performanca e përgjithshme mesatare për 2 tregues të vlerësuar është 3.66 nga 7 pikë të mundshme (52.26%).

Në nën-temën **'Menaxhimi i burimeve njerëzore'**, performanca e përgjithshme mesatare për 2 tregues të vlerësuar është 2.05 nga 8 pikë të mundshme (25.66%).

3.2.4 Rezultatet për treguesit e GPK-së në temën 'Ofrimi i shërbimeve'

Performanca mesatare e 38 komunave në 8 treguesit e vlerësuar në kuadër të temës 'Ofrimi i shërbimeve' është ~11.79 pikë nga gjithsej 26 pikë të mundshme në këtë temë (45.34%). Komuna me performancën më të lartë në këtë temë është Komuna e Glogocit. Kjo komunë ka fituar gjithsej 23 pikë nga 26 pikë të mundshme (88.46%).

Në nën-temën **'Shërbimet administrative'** performanca e përgjithshme mesatare për 2 tregues të vlerësuar është ~4.84 pikë nga 6 pikë të mundshme (80.70%).

Në nën-temën **'Planifikimi hapësinor, transporti publik dhe mjedisi'**, performanca e përgjithshme mesatare për 3 tregues të vlerësuar është 2.26 nga 8 pikë të mundshme (28.29%).

11 Treguesi nr. 6 vlerësohet pjesërisht. Totali i pikëve për këtë tregues në këtë cikël të vlerësimit është 2 pikë. Shih sqarimin në faqe 3 të këtij raporti

12 Treguesi nr.19 (me ngjyrë portokalli në Tabelën 2) është i ngrirë që do të thotë se rezultati për këtë tregues nuk do të merret parasysh në totalin e pikëve.

Në nën-temën **'Arsimi para-universitar'**, performanca e përgjithshme mesatare për 1 tregues të vlerësuar është 1.68 nga 4 pikë të mundshme (42.11%).

Në nën-temën **'Kujdesi parësor shëndetësor'**, performanca e përgjithshme mesatare për 2 tregues të vlerësuar është 3 nga 8 pikë të mundshme (37.5%).

3.2.5 Përmbledhje e rezultateve për treguesit grantit për performancë

Tabela më poshtë e tregon rezultatin final për secilën komunë si dhe rezultatin për secilën temë.

Tabela 6: Rezultati i treguesve të grantit për performancë për të gjitha komunat sipas temave

#	Komuna	Përmbledhja e rezultateve			
		Qeverisja demokratike	Menaxhimi komunal	Ofrimi I shërbimeve	Gjithsej pikë
1	Deçan/Deçane	11	8	16	35,00
2	Dragash/Dragaš	15	5	16	36,00
3	Ferizaj/Uroševac	18	13	12	43,00
4	Fushë Kosovë/Kosovo Polje	17	11	18	46,00
5	Gjakovë/Đakovica	25	12	12	49,00
6	Gjilan/Gnjilane	16	11	19	46,00
7	Glogovac/Glogovac	23	16	23	62,00
8	Gračanica/Gračanicë	10	7	2	19,00
9	Hani i Elezit/Elez Han	20,5	4	12	36,50
10	Istog/Istok	17	16	12	45,00
11	Junik/Junik	23	22	17	62,00
12	Kaçanik/Kaçanik	25	8	10	43,00
13	Kamenicë/Kamenica	12	13	16	41,00
14	Klinë/Klina	15	10	18	43,00
15	Klokot Vrbovac/Kllokot Vërbovc	9	1	0	10,00
16	Leposavić/Leposaviq	5	5	6	16,00
17	Lipjan/Lipljan	30,5	15	18	63,50
18	Malishevë/Mališevo	13	5	14	32,00
19	Mamushë/Mamuša	8	8	10	26,00
20	Mitrovicë e jugut/Južna Mitrovica	18	13	17	48,00
21	Novo Brdo/Novobërdë	3	5	4	12,00
22	Obiliq/Obilić	19	16	19	54,00
23	Parteš/Partesh	7	4	0	11,00
24	Peje/Peć	18	6	12	36,00
25	Podujevë/Podujevo	15	12	14	41,00
26	Prishtinë/Priština	14	9	12	35,00
27	Prizren/Prizren	10	12	14	36,00
28	Rahovec/Orahovac	28	16	20	64,00
29	Ranilug/Ranillug	5	2	6	13,00
30	Severna Mitrovica/Mitrovicë e veriut	1	0	0	1,00
31	Shtime/Štimlje	25	14	11	50,00
32	Skenderaj/Srbica	28	11	15	54,00
33	Štrpce/Shtërpçë	6	2	6	14,00
34	Suharekë/Suva Reka	24	8	12	44,00
35	Viti/Vitina	18	5	14	37,00
36	Vushtrri/Vučitrn	20	9	17	46,00
37	Zubin Potok/Zubin Potok	1	0	0	1,00
38	Zvečan/Zveçan	4	1	4	9,00
Mesatarja e shprehur në pikë		15,18	8,82	11,79	35,79
Mesatarja e shprehur në përqindje		39,96%	31,48%	45,34%	38,90%

3.3 Granti i performancës komunale për vitin 2022 – shumat e grantit

Në bazë të rezultateve të kushteve minimale dhe të treguesve të performancës, është plotësuar tabela e alokimit të grantit.

Tabela më poshtë tregon shumën e grantit të performancës komunale për secilën komunë, të përlogaritur sipas shembullit më poshtë për Komunën e Rahovecit.

Fillimisht është vlerësuar **përmbushja e katër kushteve minimale**. Kjo ka përcaktuar nëse komuna është përfituese e grantit ose jo. Në qoftë se komuna i ka përmbushur të katër kushtet minimale, rezultati në kolonën 5 të tabelës 7 do të jetë = 1. Në të kundërtën, në qoftë se komuna nuk i ka përmbushur të katër kushtet minimale, rezultati i kushteve minimale do të jetë zero. Në këtë rast, Komuna e Rahovecit i ka përmbushur të katër kushtet minimale dhe rezultati në kolonën (5) për Komunën e Rahovecit është = 1.

Për të llogaritur **nivelin e shumës së grantit të performancës komunale** për Komunën e Rahovecit, ndërmerren hapat për sa vijon:

1. Kolona (4): 'Pjesa relative e grantit të përgjithshëm për Komunën e Rahovecit' përcaktohet duke e pjesëtuar 'grantin e përgjithshëm të Komunës së Rahovecit' - kolona (3) me 'gjithsej shumën e grantit të përgjithshëm për alokim' - totali i kolonës 3.

Përlogaritja është kjo:

'Granti i përgjithshëm për Komunën e Rahovecit' (5,786,182.00 euro) / 'gjithsej shuma e grantit të përgjithshëm për alokim' (207,413,213.00 euro) = 'pjesa relative e grantit të përgjithshëm për Komunën e Rahovecit' (2.79%);

2. Kolona (6): 'Pikët e vlerësimit' llogariten duke i mbledhur pikët e fituara në secilin nga 28 treguesit e performancës për Komunën e Rahovecit ('pikët e vlerësimit' për komunën e Rahovecit = 64 pikë);
3. Kolona (7): 'Rezultati i ponderuar i performancës për Komunën e Rahovecit' llogaritet duke i shumëzuar 'pikët e vlerësimit' - kolona (6) me 'pjesën relative të grantit të përgjithshëm për Komunën e Rahovecit' – kolona (4) si dhe me 'rezultatit të përmbushjes së kushteve minimale' - kolona (5).

Përlogaritja është kjo:

'Pikët e vlerësimit' (64 pikë) * 'pjesa relative e grantit të përgjithshëm për Komunën e Rahovecit' (2.78%) * 'rezultati i përmbushjes së kushteve minimale' (1) = 'Rezultati i ponderuar i performancës për Komunën e Rahovecit' (1.79);

4. Kolona (8): 'Pjesa relative e rezultatit të ponderuar për Komunën e Rahovecit' llogaritet duke e pjesëtuar 'Rezultatit të ponderuar të performancës për Komunën e Rahovecit' - kolona (7) me totalin e 'rezultatit të ponderuar' - totali i kolonës (7);

Përlogaritja është kjo:

'Rezultati i ponderuar i performancës për Komunën e Rahovecit' (1.79) / 'totali i rezultatit të ponderuar' (16.91) = 'pjesa relative e rezultatit të ponderuar për Komunën e Rahovecit' (10.56%).

5. Kolona (9): 'Vlera e përlogaritur e grantit të performancës komunale për Komunën e Rahovecit' llogaritet duke e shumëzuar 'pjesën relative të rezultatit të ponderuar për Komunën e Rahovecit' – kolona (8) me 'shumën e përgjithshëm të grantit të performancës komunale në dispozicion në një vit' (7,921,500.00 euro shuma e përgjithshme e grantit të performancës komunale). Për këtë vit vlera e grantit të fituar për Komunën e Rahovecit është 752,815.70 euro. Kjo shumë paraqet 13.01% të grantit të përgjithshëm për Komunën e Rahovecit.

6. Kolona (11): 'Shpërblimi' tregon ndarjen e shpërblimit për Komunën e Rahovecit. Komuna e Rahovecit me performancën më të lartë merr 5% të shumës totale të grantit të performancës komunale që është $7,921,500 \times 5\% = 396,075.00$ euro.
7. Kolona 12 tregon vlerën totale të grantit të performancës komunale për secilën komunë pas ndarjes së shpërblimit. Pra kolonës 9 – vlera e kalkuluar për GPK për komunën e Rahovecit i shtohet shuma e shpërblimit dhe na jep totalin e vlerës së GPK për komunën e Rahovecit që është $1,148,890.70$ euro. Kjo shumë paraqet 19.86% të grantit të përgjithshëm për Komunën e Rahovecit.

Tabela 7: Alokimi i grantit për vitin 2022

Tabela e alokimit të grantit 2022														
				Vlera totale për GPK		7,921,500								
		Shpërblimi për komunën me pikët maksimale:		5.0%		396,075								
		Shpërblimi për komunën e dytë me pikët maksimale:		3.0%		237,645								
		Shpërblimi për komunën e tretë me pikët maksimale:		2.0%		158,430		(792,150)						
		Në dispozicion për alokim të bazuar në formulë:				792,150		7,129,350						
#	Komuna	Alokimi i grantit të përgjithshëm për vitin 2022 (Ligji mbi ndarjet buxhetore 2022)	Pjesa relative e grantit të përgjithshëm	Rezultatet e vlerësimit		Rezultati i llogaritur i ponderuar (4)*(5)*(6)	Pjesa relative e rezultati të ponderuar	Vlera e kalkuluar për Grantin e PK	GPK -si % e grantit të përgjithshëm	Shpërblimi	Totali i vlerës së GPK	GPK -si % e grantit të përgjithshëm		
(1)	(2)	(3)	(4)	KM Po=1	Jo=0	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10)	(11)	(12)	(13)
1	Deçan/Deçane	4,239,138	2.04%	0	35.00	0.00	0.0%	-	0.00%	-	-	0.00%		
2	Dragash/Dragaš	4,499,031	2.17%	1	36.00	0.78	4.6%	329,259.33	7.32%	-	329,259.33	7.32%		
3	Ferizaj/Uroševac	11,039,330	5.32%	0	43.00	0.00	0.0%	-	0.00%	-	-	0.00%		
4	Fushë Kosovë/Kosovo Po	3,736,842	1.80%	0	46.00	0.00	0.0%	-	0.00%	-	-	0.00%		
5	Gjakovë/Dakovica	9,531,885	4.60%	0	49.00	0.00	0.0%	-	0.00%	-	-	0.00%		
6	Gjilan/Gnjilane	9,242,581	4.46%	1	46.00	2.05	12.1%	864,306.35	9.35%	-	864,306.35	9.35%		
7	Glogovc/Glogovac	5,929,721	2.86%	1	62.00	1.77	10.5%	747,381.86	12.60%	158,430	905,811.86	15.28%		
8	Gračanica/Gračanicë	2,114,190	1.02%	1	19.00	0.19	1.1%	81,660.91	3.86%	-	81,660.91	3.86%		
9	Hani i Elezit/ Elez Han	1,112,582	0.54%	1	36.50	0.20	1.2%	82,554.64	7.42%	-	82,554.64	7.42%		
10	Istog/Istok	4,468,536	2.15%	0	45.00	0.00	0.0%	-	0.00%	-	-	0.00%		
11	Junik/Junik	789,259	0.38%	0	62.00	0.00	0.0%	-	0.00%	-	-	0.00%		
12	Kaçanik/Kaçanik	3,501,206	1.69%	1	43.00	0.73	4.3%	306,057.29	8.74%	-	306,057.29	8.74%		
13	Kamenicë/Kamenica	4,071,728	1.96%	0	41.00	0.00	0.0%	-	0.00%	-	-	0.00%		
14	Klinë/Klina	4,145,145	2.00%	0	43.00	0.00	0.0%	-	0.00%	-	-	0.00%		
15	Klokot Vrbovac/Kllokot V	467,273	0.23%	0	10.00	0.00	0.0%	-	0.00%	-	-	0.00%		
16	Leposavić/Leposaviq	2,857,731	1.38%	0	16.00	0.00	0.0%	-	0.00%	-	-	0.00%		
17	Lipjan/Lipljan	6,069,157	2.93%	1	63.50	1.86	11.0%	783,463.38	12.91%	237,645	1,021,108.38	16.82%		
18	Malishevë/Mališevo	5,275,857	2.54%	0	32.00	0.00	0.0%	-	0.00%	-	-	0.00%		
19	Mamushë/Mamuša	1,048,114	0.51%	0	26.00	0.00	0.0%	-	0.00%	-	-	0.00%		
20	Mitrovicë e jugut/Južna M	7,106,748	3.43%	1	48.00	1.64	9.7%	693,471.73	9.76%	-	693,471.73	9.76%		
21	Novo Brdo/Novobërdë	1,154,537	0.56%	0	12.00	0.00	0.0%	-	0.00%	-	-	0.00%		
22	Obiliq/Obilić	7,361,675	3.55%	1	54.00	1.92	11.3%	808,140.75	10.98%	-	808,140.75	10.98%		
23	Parteš/Partesh	447,843	0.22%	0	11.00	0.00	0.0%	-	0.00%	-	-	0.00%		
24	Pejë/Peć	10,400,928	5.01%	1	36.00	1.81	10.7%	761,186.71	7.32%	-	761,186.71	7.32%		
25	Podujevë/Podujevo	8,765,246	4.23%	0	41.00	0.00	0.0%	-	0.00%	-	-	0.00%		
26	Prishtinë/Priština	31,252,412	15.07%	0	35.00	0.00	0.0%	-	0.00%	-	-	0.00%		
27	Prizren/Prizren	18,261,786	8.80%	0	36.00	0.00	0.0%	-	0.00%	-	-	0.00%		
28	Rahovec/Orahovac	5,786,182	2.79%	1	64.00	1.79	10.56%	752,815.70	13.01%	396,075	1,148,890.70	19.86%		
29	Ranilug/Ranilug	821,015	0.40%	0	13.00	0.00	0.0%	-	0.00%	-	-	0.00%		
30	Severna Mitrovica/Mitrov	2,103,762	1.01%	0	1.00	0.00	0.0%	-	0.00%	-	-	0.00%		
31	Shtime/Štimlje	2,892,454	1.39%	0	50.00	0.00	0.0%	-	0.00%	-	-	0.00%		
32	Skenderaj/Srbica	5,314,687	2.56%	0	54.00	0.00	0.0%	-	0.00%	-	-	0.00%		
33	Štrpce/Shtërpçë	1,220,140	0.59%	1	14.00	0.08	0.5%	34,725.96	2.85%	-	34,725.96	2.85%		
34	Suharekë/Suva Reka	5,807,940	2.80%	1	44.00	1.23	7.3%	519,507.00	8.94%	-	519,507.00	8.94%		
35	Viti/Vitina	4,850,186	2.34%	1	37.00	0.87	5.1%	364,818.39	7.52%	-	364,818.39	7.52%		
36	Vushtrri/Vučitrn	6,709,131	3.23%	0	46.00	0.00	0.0%	-	0.00%	-	-	0.00%		
37	Zubin Potok/Zubin Potok	1,567,328	0.76%	0	1.00	0.00	0.0%	-	0.00%	-	-	0.00%		
38	Zvečan/Zvečan	1,449,907	0.70%	0	9.00	0.00	0.0%	-	0.00%	-	-	0.00%		
	Total/Mesatarja	207,413,213	100.00%	14	35.79	16.91	100.0%	7,129,350	3.44%	792,150	7,921,500.00	3.82%		

3.4 Përmbledhje e rezultateve finale të vlerësimit dhe rekomandime

Rezultatet e vlerësimit tregojnë se 14 nga 38 komunat e vlerësuara kanë zbatuar një sistem të shëndoshë të menaxhimit të financave komunale gjatë vitit 2020, sipas kushteve minimale të përcaktuara në grantin e performancës komunale. Këto 14 komuna janë kualifikuar për grantin e performancës komunale që do të transferohet tek komunat në vitin 2022.

Rezultatet e vlerësimit për 28 treguesit e performancës për vitin 2020 tregojnë se shumica e komunave kanë treguar një performancë mesatare në këta tregues. Mesatarja e përgjithshme e 38 komunave për 28 treguesit e performancës është 35.79 pikë nga gjithsej 92 pikë të mundshme (38.90%). Vlen të theksohet se një numër i komunave të cilat nuk i kanë përmbushur kushtet minimale për grantin e performancës komunale, kanë treguar performancë mbi-mesatare në treguesit e performancës¹³.

Të dhënat tregojnë se në disa tregues, performanca mesatare është më e dobët. Kjo kërkon analiza shtesë për secilin tregues.

Të dhënat poashtu sugjerojnë se nuk ka dallime ndërmjet komunave me numër të popullsisë ose sipërfaqe së ndryshme në rezultatin e përgjithshëm të performancës. Megjithatë, faktorë të tillë kanë ndikuar në përcaktimin e lartësisë e grantit të performancës komunale.

Shuma e grantit që komunat do të marrin komunat në vitin 2022 varion nga 34,725.96 Euro¹⁴ deri në 1,148,890.70Euro¹⁵. Shtesa relative që komunat do të marrin varion nga 2.85%¹⁶ deri në 19.86%¹⁷ të grantit të përgjithshëm komunal.

Nga sa u tha më lart, rezulton se granti i performancës komunale për vitin 2022 në shumën e përgjithshme 7,9 milion euro do t'u ndahet 14 komunave të cilat i kanë përmbushur të katër kushtet minimale. Lartësia e grantit për secilën komunë është përcaktuar nga performanca e tyre në krahasim me performancën e komunave të tjera përfituese si dhe nga pesha e grantit të performancës komunale në grantin e përgjithshëm të alokuar për vitin 2022. Gjithashtu për tri komunat me performancën më të mirë është përcaktuar vlera e shpërblimit sipas rregullave të GPK.

Rekomandohet Komisioni i Grantit të Performancës Komunale që të aprovojë rezultatet e vlerësimit dhe shumat e kalkuluara për alokim të grantit të performancës komunale për vitin 2022.

Shtojcat

- Shtojca 1 – Rezultati i përgjithshëm i kushteve minimale – performanca e vitit 2020
- Shtojca 2 – Rezultati i përgjithshëm i treguesve të performancës sipas fushave, nënfushave dhe treguesve
- Shtojca 3 – Përmbledhje e rezultatit të performancës individuale të komunave

13 Komuna Junik, Skenderaj, Shtime, Gjakovë

14 Komuna Shtërpce

15 Komuna Rahovec

16 Komuna Shtërpce

17 Komuna Rahovec

Shtojca 1 – Rezultati i përgjithshëm i kushteve minimale – performanca e vitit 2020

#	Komuna	Performanca e vitit 2020						Vlerësimi KM-ve	Vlerësimi
		KM1	KM2	KM3	KM4	S u m KM			
1	Deçan/Deçane	1	0	0	1	2	Jo	Komuna nuk kualifikohet	
2	Dragash/Dragaš	1	1	1	1	4	Po	Komuna kualifikohet	
3	Ferizaj/Uroševac	1	1	0	1	3	Jo	Komuna nuk kualifikohet	
4	Fushë Kosovë/Kosovo Polje	1	1	1	0	3	Jo	Komuna nuk kualifikohet	
5	Gjakovë/Dakovica	1	0	1	1	3	Jo	Komuna nuk kualifikohet	
6	Gjilan/Gnjilane	1	1	1	1	4	Po	Komuna kualifikohet	
7	Glllogovc/Glogovac	1	1	1	1	4	Po	Komuna kualifikohet	
8	Gračanica/Gračanicë	1	1	1	1	4	Po	Komuna kualifikohet	
9	Hani i Elezit/Elez Han	1	1	1	1	4	Po	Komuna kualifikohet	
10	Istog/Istok	1	1	0	1	3	Jo	Komuna nuk kualifikohet	
11	Junik/Junik	1	1	0	1	3	Jo	Komuna nuk kualifikohet	
12	Kaçanik/Kaçanik	1	1	1	1	4	Po	Komuna kualifikohet	
13	Kamenicë/Kamenica	1	0	0	1	2	Jo	Komuna nuk kualifikohet	
14	Klinë/Klina	1	0	1	1	3	Jo	Komuna nuk kualifikohet	
15	Klokot Vrbovac/ Klllokot Vërbovc	1	1	0	0	2	Jo	Komuna nuk kualifikohet	
16	Leposavić/Leposaviq	1	1	0	1	3	Jo	Komuna nuk kualifikohet	
17	Lipjan/Lipljan	1	1	1	1	4	Po	Komuna kualifikohet	
18	Malishevë/Mališevo	1	0	1	1	3	Jo	Komuna nuk kualifikohet	
19	Mamushë/Mamuša	1	1	0	1	3	Jo	Komuna nuk kualifikohet	
20	Mitrovicë e jugut/ Južna Mitrovica	1	1	1	1	4	Po	Komuna kualifikohet	
21	Novo Brdo/ Novobërdë	1	1	0	0	2	Jo	Komuna nuk kualifikohet	
22	Obiliq/Obilić	1	1	1	1	4	Po	Komuna kualifikohet	
23	Parteš/Partesh	1	0	0	0	1	Jo	Komuna nuk kualifikohet	
24	Peje/Peć	1	1	1	1	4	Po	Komuna kualifikohet	
25	Podujevë/Podujevo	1	1	0	1	3	Jo	Komuna nuk kualifikohet	
26	Prishtinë/Priština	1	0	1	0	2	Jo	Komuna nuk kualifikohet	
27	Prizren/Prizren	1	0	1	0	2	Jo	Komuna nuk kualifikohet	
28	Rahovec/Orahovac	1	1	1	1	4	Po	Komuna kualifikohet	
29	Ranilug/Ranillug	1	0	1	0	2	Jo	Komuna nuk kualifikohet	
30	Severna Mitrovica/ Mitrovicë e veriut	0	1	0	0	1	Jo	Komuna nuk kualifikohet	
31	Shtime/Štimlje	1	1	1	0	3	Jo	Komuna nuk kualifikohet	
32	Skenderaj/Srbica	1	1	1	0	3	Jo	Komuna nuk kualifikohet	
33	Štrpce/Shtërpçë	1	1	1	1	4	Po	Komuna kualifikohet	
34	Suharekë/Suva Reka	1	1	1	1	4	Po	Komuna kualifikohet	
35	Viti/Vitina	1	1	1	1	4	Po	Komuna kualifikohet	
36	Vushtrri/Vučitrn	1	1	1	0	3	Jo	Komuna nuk kualifikohet	
37	Zubin Potok/Zubin Potok	1	1	0	0	2	Jo	Komuna nuk kualifikohet	
38	Zvečan/Zveçan	1	1	0	0	2	Jo	Komuna nuk kualifikohet	
	Total	37	29	24	25	14	14		

Rezultati i performancës në fushën 1: Qeverisja Demokratike

#	Komuna	1. Roli i kuvendit komunal si organ mbikëqyrës											2. Pjesëmarrja, konsultimi dhe gjthëpërfshirja e qytetarëve							3. Transparenca, qasja në informata dhe integriteti					Gjithsej pikë
		TP1	TP2	TP3	TP4	TP5	Tot I I	TP6	TP7	TP8	Tot II	TP9	TP10	TP11	TP12	TP13	Tot III	Total							
1	Dečan/Deçane	2	1	0	0	1	4	0	4	0	4	0	4	0	2	1	0	3	11						
2	Dragash/Dragaš	2	3	0	2	2	9	0	1	3	1	4	0	1	3	0	5	15							
3	Ferizaj/Uroševac	2	3	0	2	0	7	0	4	0	4	0	4	2	0	7	18								
4	Fushë Kosovë/Kosovo Polje	2	3	0	0	0	5	0	4	4	8	0	2	2	0	4	17								
5	Gjakovë/Dakovica	2	3	2	2	2	11	0	4	1	5	3	4	0	0	9	25								
6	Gjilan/Grijllane	2	3	0	0	0	5	0	1	2	3	4	1	0	0	8	16								
7	Gilgovic/Glogovac	2	3	2	2	1	10	0	1	4	5	4	2	0	2	8	23								
8	Gračanica/Gračanicë	2	1	0	0	0	3	0	0	4	4	0	2	1	0	3	10								
9	Hani i Elezit/Elez Han	2	3	2	4	1	12	0.5	1	4	5.5	0	2	1	0	3	20.5								
10	Istog/Istok	2	1	0	2	1	6	0	4	1	5	3	2	1	0	6	17								
11	Junik/Junik	2	1	0	2	2	7	0	4	4	8	2	4	2	0	8	23								
12	Kaçanik/Kaçanik	2	1	2	2	2	9	0	4	4	8	0	4	2	0	8	25								
13	Kamenicë/Kamenica	0	3	0	2	1	6	2	0	0	2	0	2	0	0	4	12								
14	Klinë/Klina	2	3	0	0	2	7	0	2	0	2	3	2	1	0	6	15								
15	Klokot Vrbovac/Klokot Vërbovc	2	1	2	2	0	7	0	0	0	0	0	2	0	0	2	9								
16	Leposaviç/Leposaviq	2	1	0	0	2	5	0	0	0	0	0	0	0	0	0	5								
17	Lipjan/Lipjan	2	3	2	4	2	13	0.5	4	2	8.5	3	4	2	0	9	30.5								
18	Malishevë/Mališevo	2	3	0	2	0	7	0	2	0	2	0	2	0	0	4	13								
19	Mamushë/Mamuša	2	1	0	2	1	6	0	0	0	0	0	2	0	0	2	8								
20	Mitrovicë e jugut/Južna Mitrovicë	0	1	0	2	1	4	0	4	4	8	0	4	2	0	6	18								
21	Novo Brdo/Novobërdë	2	1	0	0	0	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3								
22	Obiliq/Obiliç	2	3	0	2	1	8	0	1	4	5	0	4	2	0	6	19								
23	Parteš/Partesh	2	1	0	0	0	3	0	0	4	4	0	0	0	0	0	7								
24	Pejë/Peç	2	3	2	2	1	10	0	0	0	0	2	2	2	0	8	18								
25	Podujevë/Podujevo	2	3	0	2	0	7	0	4	1	5	0	2	1	0	3	15								
26	Priştinë/Priština	0	1	0	0	1	2	0	4	0	4	3	4	1	0	8	14								
27	Prizren/Prizren	0	1	0	0	2	3	0	0	0	0	3	2	2	0	7	10								
28	Rahovec/Orahovac	2	3	2	2	2	11	0	4	4	8	3	4	2	0	9	28								
29	Ranilug/Ranillug	2	1	0	0	1	4	0	0	0	0	0	1	0	0	1	5								
30	Severna Mitrovica/Mitrovicë e v	0	1	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1								
31	Shtime/Štimlje	2	3	2	2	1	10	2	4	4	8	2	4	1	0	7	25								
32	Skenderaj/Srbica	2	3	2	2	2	11	2	4	4	10	2	2	1	0	7	28								
33	Štrpcë/Shtërpcë	2	1	0	0	0	3	0	0	0	0	0	2	1	0	3	6								
34	Suharekë/Suva Reka	2	3	0	2	2	9	0	4	4	8	2	4	1	0	7	24								
35	Viti/Vitina	2	3	0	2	1	8	0	4	1	5	1	2	2	0	5	18								
36	Vushtri/Vučitri	2	3	0	2	2	9	0	4	0	4	3	2	2	0	7	20								
37	Zubin Potok/Zubin Potok	0	1	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1								
